VENDIM
Nr. 196, datë 30.8.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMET E BORDIT TË ERE-s NR. 120, DATË 4.6.2018, "MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2018 TË SHOQËRISË 'ALBGAZ' SHA" DHE NR. 121, DATË 4.6.2018, "MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E PLANIT 10-VJEÇAR TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË SHOQËRISË 'ALBGAZ' SHA"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 16, pika 12; neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror"; nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative"; neneve 8 dhe 9, të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror" dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës për një ndryshim në vendimet e Bordit të ERE-s nr. 120, datë 4.6.2018, "Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2018 të shoqërisë 'Albgaz' sh.a." dhe nr. 121, datë 4.6.2018, "Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë 'Albgaz' sh.a.",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 120, datë 4.6.2018, filloi procedurën për miratimin e planit të investimeve për vitin 2018 të shoqërisë "Albgaz" sh.a. dhe me vendimin nr. 121, datë 4.6.2018, filloi procedurën për miratimin e planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë "Albgaz" sh.a.

- Sa më sipër, shoqëria "Albgaz" sh.a., në zbatim të vendimeve sipërcituar duhej të depozitonte pranë ERE-s jo më vonë se 30 ditë nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave:

- Për vendimin nr. 120, datë 4.6.2018:

- Miratimet nga Këshilli Mbikëqyrës, të Planit të Investimeve për vitin 2018, që reflektojnë ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43 prot., datë 21.3.2018 dhe nr. 43/1 prot., datë 14.5.2015.

- Argumentime më të detajuara lidhur me projektet.

- Për vendimin nr. 121, datë 4.6.2018:

- Miratim nga Këshilli Mbikëqyrës, të Planit të Zhvillimit të Rrjetit për periudhën 2018–2027, që reflekton ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43 prot., datë 21.3.2018 dhe nr. 43/1 prot., datë 14.5.2015.

- Argumentime më të detajuara lidhur me projektet.

- Në vijim të sa më sipër, ERE, me shkresën nr. 454 prot., datë 14.6.2018, bëri me dije shoqërinë "Albgaz" sh.a. për vendimmarrjet e sipërcituara, në të cilat pasqyrohej detyrimi për të përmbushur mungesën e dokumentacionit dhe kushteve të vendosura në dispozitivët e vendimeve për plotësimin e dokumentacionit të munguar brenda afateve të përcaktuara.

- Në përgjigje të korrespondencës së sipërcituar të ERE-s shoqëria "Albgaz" sh.a. me shkresën nr. 454/1 prot. i ERE-s, datë 13.7.2018, ka informuar ERE-n mbi përmbushjen e detyrimeve mbi planin e investimeve për vitin 2018, si dhe planin 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit. "Albgaz" sh.a. për vitin 2018 parashikon projekte të reja në lidhje me ngritjen e kapaciteteve, si dhe trajnimin e stafit në kuadër të investimeve strategjike (Gas Masterplan) ku gazsjellësi TAP AG do ketë rol suportues në implementimin e projektit. Në këtë kuadër, në mënyrë që të bëhet e mundur ecja me ritme sa më të shpejta e procesit të punës, "Albgaz" sh.a. informon ERE-n se është në negociata me TAP AG për finalizimin e marrëveshjes ku përfshihet edhe mbulimi i investimeve për ngritjen e kapaciteteve.

- Po ashtu, duke pasur parasysh edhe ndryshimet në drejtimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., si dhe strukturave të ministrive nga të cilat ky subjekt ka varësi, është bërë me dije se po merren të gjitha

masat e nevojshme për plotësimin e pikave të kërkuara në vendimet nr. 120 dhe 121, datë 4.6.2018.

- Së fundmi, shoqëria "Albgaz" sh.a. në korrespondencën e saj nr. 454/1 prot. i ERE-s, datë 13.7.2018, ka përcjellë në ERE kërkesën për shtyrjen e afatit të vendosur në pikën 2, të vendimeve nr. 120 dhe nr. 121, datë 4.6.2017, për plotësimin e dokumentacionit të munguar, deri në datën 20.10.2018, për arsyet e sipërcituara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 120, datë 4.6.2018, "2. "Albgaz" sh.a. të depozitojë pranë ERE-s jo më vonë se 30 ditë nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave: - Miratimet nga Këshilli Mbikëqyrës, të Planit të Investimeve për vitin 2018 që reflektojnë ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43 prot., datë 21.3.2018 dhe nr. 43/1 prot., datë 14.5.2015. - Argumentime më të detajuara lidhur me projektet…" ndryshon dhe bëhet: "2. "Albgaz" sh.a. të depozitojë pranë ERE-s jo më vonë se data 20.10.2018: - Miratimet nga Këshilli Mbikëqyrës, të Planit të Investimeve për vitin 2018 që reflektojnë ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43 prot., datë 21.3.2018 dhe nr. 43/1 prot., datë 14.5.2015. - Argumentime më të detajuara lidhur me projektet.".

2. Pika 2 e vendimit nr. 121, datë 4.6.2018, "2. "Albgaz" sh.a. të depozitojë pranë ERE-s jo më vonë se 30 ditë nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave: - Miratim nga Këshilli Mbikqyrës, të Planit të zhvillimit të rrjetit për periudhën 2018–2027, që reflekton ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43 prot., datë 21.3.2018 dhe nr. 43/1 prot., datë 14.5.2015. - Argumentime më të detajuara lidhur me projektet…", ndryshon dhe bëhet: "2. "Albgaz" sh.a. të depozitojë pranë ERE-s jo më vonë se data 20.10.2018: - Miratim nga Këshilli Mbikëqyrës, të Planit të zhvillimit të rrjetit për periudhën 2018–2027, që reflekton ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43 prot., datë 21.3.2018 dhe nr. 43/1 prot., datë 14.5.2015. - Argumentime më të detajuara lidhur me projektet".

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të përcjellë këtë vendim pranë "Albgaz" sh.a. dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti